

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Kufizimi i përhapjes së kafshëve endacake.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **03325000-3, 85200000-1.**

VLERA E FONDIT LIMIT: **1 650 000 (një milion e gjashtëqindpesëdhjetëmijë) Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor: **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. *Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë objektin e prokurimit në objektin e veprimtarisë së deklaruar në QKB.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) *përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

Kërkesa që operatori ekonomik të ketë të përfshirë objektin e prokurimit në objektin e veprimtarisë së deklaruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) është vendosur për të garantuar se subjekti pjesëmarrës ushtron në mënyrë të ligjshme veprimtarinë që lidhet me realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe se disponon profilin e nevojshëm profesional për ofrimin e këtij shërbimi. Objekti i prokurimit “Kufizimi i përhapjes së kafshëve endacake” përfshin një sërë veprimtarish të specializuara, të cilat lidhen me kapjen, transportimin, trajtimin, kontrollin veterinar, sterilizimin, vaksinimin, identifikimin dhe menaxhimin e kafshëve endacake, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e kafshëve dhe shëndetin veterinar.

Për shkak të natyrës specifike të këtij shërbimi, autoriteti kontraktor vlerëson të domosdoshme që operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedurë të kenë të deklaruar në objektin e aktivitetit të tyre veprimtari që lidhen drejtpërdrejt ose në mënyrë të përafërt me shërbimet veterinarë, trajtimin e kafshëve, menaxhimin e strehimeve për kafshët, kontrollin e popullatës së kafshëve apo veprimtari të tjera të ngjashme që lidhen me objektin e kontratës. Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik të mos jetë një subjekt që ushtron veprimtari të papërputhshme me shërbimin që kërkohet, por të jetë i orientuar profesionalisht dhe ligjërisht drejt fushës për të cilën zhvillohet procedura e prokurimit.

Vendosja e këtij kriteri i shërben verifikimit të aftësisë ligjore dhe profesionale të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën, duke krijuar garanci se ai ka organizimin, strukturën dhe përvojën e nevojshme për të përmbushur detyrimet kontraktore. Gjithashtu, përfshirja e veprimtarisë përkatëse në objektin e regjistruar në QKB dëshmon se operatori ekonomik e ushtron këtë aktivitet në mënyrë të rregullt dhe të njohur ligjërisht, duke kontribuar në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së realizimit të kontratës.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij ose të disponojë nëpërmjet kontratës së punës/bashkëpunimit të paktën një (1) mjek veterinar të pajisur me Leje Profesionale të vlefshme, të lëshuar nga organet kompetente në zbatim të ligjit nr. 113/2015, datë 22.10.2015, “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”. Dokumentacioni duhet të vërtetojë vlefshmërinë e lejes në momentin e dorëzimit të ofertës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës” dhe nenin 41, pika 4, gërma (c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Për të provuar

përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës”.

Kërkesa që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij ose të disponojë nëpërmjet kontratës së punës apo bashkëpunimit të paktën një (1) mjek veteriner të pajisur me Leje Profesionale të vlefshme, të lëshuar në zbatim të ligjit nr. 113/2015, datë 22.10.2015, “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veteriner”, është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën dhe specifikat e objektit të prokurimit “Kufizimi i përhapjes së kafshëve endacake”, i cili përfshin veprimtari që kërkojnë njohuri dhe kompetenca profesionale veterinare të specializuara.

Shërbimet që lidhen me menaxhimin e kafshëve endacake përfshijnë procese të tilla si kontrolli shëndetësor i kafshëve, vlerësimi i gjendjes së tyre veterinare, vaksinimi, sterilizimi, trajtimet mjekësore, identifikimi, si dhe ndjekja e procedurave që lidhen me mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Këto procese, sipas legjislacionit veterinar në fuqi, mund të kryhen vetëm nga persona që zotërojnë kualifikimin profesional përkatës dhe janë të pajisur me leje profesionale të vlefshme për ushtrimin e profesionit të mjekut veteriner.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor e konsideron të domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë të paktën një mjek veteriner të licencuar, i cili do të garantojë realizimin e shërbimeve sipas standardeve profesionale dhe kërkesave ligjore në fuqi. Prania e një mjeku veteriner të autorizuar përbën një garanci për kryerjen e procedurave veterinare në mënyrë të sigurt, profesionale dhe në përputhje me normat teknike e etike që rregullojnë ushtrimin e profesionit.

Kërkesa për paraqitjen e Lejes Profesionale të vlefshme synon të verifikojë se profesionisti që do të angazhohet në realizimin e kontratës është i regjistruar dhe i autorizuar ligjërisht për ushtrimin e profesionit, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veteriner”. Gjithashtu, kërkesa që vlefshmëria e lejes të provohet në momentin e dorëzimit të ofertës është e nevojshme për të garantuar që operatori ekonomik disponon realisht kapacitetin profesional të kërkuar gjatë fazës së konkurrimit dhe jo vetëm pas shpalljes fitues.

Ky kriter siguron disponimin e burimit minimal profesional të domosdoshëm për realizimin e kontratës. Për më tepër, ai lidhet drejtpërdrejt me cilësinë, sigurinë dhe ligjshmërinë e shërbimit që do të ofrohet, duke garantuar mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, sigurinë publike dhe përmbushjen e objektivave të programit për kufizimin e përhapjes së kafshëve endacake.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 35 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP të ndryshuar, nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ” 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 35 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.

Në nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të

shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”, nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 15 % të vlerës së fondit limit.

Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e shërbimeve të ngjashme me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 “Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) mjet transporti të përshtatshëm për kapjen, transportin dhe trajtimin e kafshëve endacake.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjetit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- a) leje qarkullimi në pronësi të operatorit ekonomik;*
- b) kontratë qiraje;*
- c) kontratë huapërdorjeje;*
- d) çdo dokument tjetër që provon disponimin e ligjshëm të mjetit për periudhën e zbatimit të kontratës.*

Për mjetin duhet të paraqitet leja e qarkullimit e vlefshme dhe dokumentacioni që provon kontrollin teknik dhe siguracionin e vlefshëm, sipas legjislacionit në fuqi.”

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/c, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku parashikohet se *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”*.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën një mjet transporti të përshtatshëm për kapjen, transportin dhe trajtimin e kafshëve endacake është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe objektivin e kontratës, duke qenë se realizimi i shërbimit kërkon ndërhyrje në terren dhe transportimin e sigurt të kafshëve nga vendndodhja e kapjes drejt ambienteve të trajtimit, sterilizimit, vaksinimit ose strehimit të përkohshëm.

Objekti i prokurimit përfshin aktivitete operative që nuk mund të realizohen pa disponimin e mjeteve të posaçme dhe të përshtatshme për transportin e kafshëve. Gjatë zbatimit të kontratës, operatori ekonomik do të duhet të kryejë kapjen dhe transportimin e kafshëve në mënyrë të vazhdueshme, duke respektuar kërkesat për mirëqenien e tyre, sigurinë e personelit dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Për këtë arsye, disponimi i një mjeti të përshtatshëm përbën një kapacitet teknik minimal dhe të domosdoshëm për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë synon të garantojë që operatori ekonomik të jetë në gjendje të përgjigjet në kohë ndaj nevojave të autoritetit kontraktor dhe të kryejë transportin e kafshëve në kushte të sigurta dhe humane, duke shmangur dëmtimin e tyre, shkaktimin e stresit të panevojshëm ose krijimin e rrezikut për qytetarët dhe përdoruesit e rrugës. Mjeti i transportit duhet të mundësojë lëvizjen e kafshëve në përputhje me standardet veterinare dhe kërkesat ligjore për trajtimin e tyre, duke siguruar kushte të përshtatshme higjieno-sanitare dhe kontroll gjatë transportit.

Kërkesa që operatori ekonomik të provojë disponimin e ligjshëm të mjetit, qoftë nëpërmjet pronësisë, kontratës së qirasë, kontratës së huapërdorjes ose çdo forme tjetër të ligjshme, është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të mosdiskriminimit, pasi nuk kufizon pjesëmarrjen vetëm tek operatorët që zotërojnë mjetin në pronësi, por u jep mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të provojnë se e kanë në dispozicion këtë kapacitet teknik gjatë periudhës së zbatimit të kontratës.

Po ashtu, kërkesa për paraqitjen e lejes së qarkullimit, dokumentacionit të kontrollit teknik dhe siguracionit të vlefshëm synon të garantojë që mjeti i përdorur për realizimin e kontratës është i autorizuar për qarkullim, teknikisht i përshtatshëm dhe i sigurt për përdorim. Këto dokumente vërtetojnë se mjeti plotëson kushtet ligjore për transport dhe minimizojnë rrezikun e ndërprerjes së shërbimit për shkak të problemeve teknike apo administrative gjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3.3 “Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 (një) pajisje profesionale për neutralizimin/immobilizimin në distancë të kafshëve endacake (pushkë neutralizuese me shigjeta/dart veterinare), e përshtatshme për kapjen dhe trajtimin human të kafshëve, në përputhje me standardet e mirëqenies së kafshëve dhe legjislacionin veterinar në fuqi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e pushkës në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- *faturë tatimore blerjeje;*
- *kontratë qiraje ose huapërdorjeje;*
- *akt pronësie ose dokument tjetër ekuivalent që provon disponimin e ligjshëm të saj.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/c, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku parashikohet se *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”*

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën një pajisje profesionale për neutralizimin/immobilizimin në distancë të kafshëve endacake, e përshtatshme për përdorim veterinar, është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit dhe me nevojën për realizimin e sigurt, efektiv dhe human të shërbimeve që lidhen me kontrollin e popullatës së kafshëve endacake.

Në kuadër të zbatimit të kontratës, operatori ekonomik mund të përballet me raste kur kapja e kafshëve nuk mund të realizohet në mënyrë të drejtpërdrejtë për shkak të sjelljes agresive, gjendjes së stresit, frikës, dëmtimeve fizike ose rrezikut që ato mund të paraqesin për personelin e angazhuar dhe qytetarët. Në këto situata, përdorimi i pajisjeve profesionale për immobilizim veterinar përbën një mjet teknik të nevojshëm që mundëson ndërhyrjen në distancë, duke minimizuar rrezikun e lëndimeve si për kafshët ashtu edhe për personelin që kryen shërbimin.

Disponimi i kësaj pajisjeje garanton që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike të nevojshme për të përballuar të gjitha situatat që mund të paraqiten gjatë zbatimit të kontratës, veçanërisht rastet kur kapja me metoda të zakonshme nuk është e mundur ose mund të shkaktojë pasoja për sigurinë publike. Përdorimi i pajisjeve profesionale të immobilizimit veterinar konsiderohet një praktikë e njohur në menaxhimin e kafshëve endacake, pasi mundëson kontrollin e tyre në mënyrë humane dhe me stres minimal, duke respektuar standardet e mirëqenies së kafshëve dhe kërkesat e legjislacionit veterinar.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit që provon disponimin e ligjshëm të pajisjes, qoftë nëpërmjet faturës së blerjes, kontratës së qirasë, kontratës së huapërdorjes ose dokumenteve të tjera ekuivalente, synon të sigurojë që operatori ekonomik e ka realisht në dispozicion këtë kapacitet teknik gjatë periudhës së zbatimit të kontratës. Njëkohësisht, kjo kërkesë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi nuk kufizon pjesëmarrjen vetëm tek operatorët që e zotërojnë pajisjen në pronësi, por u mundëson të gjithë operatorëve ekonomikë të provojnë disponimin e saj në forma të ndryshme të ligjshme.

Ky kriter garanton që operatori ekonomik disponon mjetet teknike të nevojshme për kapjen dhe trajtimin e kafshëve endacake në mënyrë të sigurt, humane dhe në përputhje me standardet veterinare dhe kërkesat ligjore në fuqi, duke siguruar realizimin efektiv të objektivave të kontratës dhe mbrojtjen e interesit publik.

2.3.4 “Operatori ekonomik duhet të disponojë klinikë/studio veterinare të licencuar, të vendosur brenda territorit të Qarkut Vlorë, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate.

Argumentimi: Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikë 6 të nenit 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë një klinikë ose studio veterinare të licencuar, të vendosur brenda territorit të Qarkut Vlorë, është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit dhe me nevojën për garantimin e realizimit në kohë, me cilësi dhe në përputhje me standardet veterinare të shërbimeve që lidhen me kufizimin e përhapjes së kafshëve endacake.

Zbatimi i kontratës nuk kufizohet vetëm në kapjen dhe transportimin e kafshëve, por përfshin edhe kryerjen e procedurave veterinare, kontrollin shëndetësor, trajtimin e rasteve që paraqesin probleme mjekësore, vaksinimin, sterilizimin ose kastrimin, si dhe monitorimin pas ndërhyrjes. Këto procese kërkojnë ambiente të përshtatshme, të licencuara dhe të pajisura sipas kërkesave të legjislacionit veterinar në fuqi, në mënyrë që ndërhyrjet të realizohen në kushte teknike dhe higjieno-sanitare të sigurta.

Kërkesa për disponimin e një klinike ose studioje veterinare të licencuar garanton që operatori ekonomik ka në dispozicion infrastrukturën minimale të nevojshme për kryerjen e procedurave që parashikohen në kuadër të kontratës dhe se këto procedura do të realizohen në ambiente të autorizuara nga organet kompetente. Licencimi i klinikës ose studios veterinare përbën një garanci se ambientet plotësojnë standardet ligjore dhe teknike për ushtrimin e veprimtarisë veterinare dhe se shërbimet do të ofrohen në përputhje me kërkesat profesionale dhe normat e mirëqenies së kafshëve.

Vendosja e klinikës ose studios veterinare brenda territorit të Qarkut Vlorë justifikohet nga nevoja për të siguruar reagim të shpejtë dhe efikas gjatë zbatimit të kontratës, duke minimizuar kohën e transportit të kafshëve nga vendi i kapjes drejt ambienteve ku do të kryhen procedurat veterinare. Distanca e gjata të transportit mund të ndikojnë negativisht në gjendjen e kafshëve, të rrisin nivelin e stresit dhe të krijojnë vështirësi operative në realizimin e shërbimit. Gjithashtu, disponimi i një strukture veterinare brenda territorit ku do të ofrohet shërbimi mundëson ndërhyrje më të shpejta në rastet urgjente, monitorim më efektiv të kafshëve dhe menaxhim më të mirë të procesit në tërësi. Kjo kërkesë synon gjithashtu të sigurojë vazhdimësinë dhe disponueshmërinë e shërbimit gjatë gjithë periudhës së kontratës, duke garantuar që operatori ekonomik ka kapacitet real për të

përballuar fluksin e punës dhe për të realizuar të gjitha procedurat veterinarë të nevojshme pa vonesa që mund të cenojnë arritjen e objektivave të kontratës. Për më tepër, prania e një strukture veterinarë në territorin ku do të zhvillohet shërbimi lehtëson kontrollin dhe monitorimin e zbatimit të kontratës nga autoriteti kontraktor.

Ky kriter garanton që operatori ekonomik disponon infrastrukturën profesionale dhe logjistike të nevojshme për realizimin e shërbimeve veterinarë në kohë, me cilësi dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen e mirëqenies së kafshëve dhe realizimin efektiv të qëllimit të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Objekti i shërbimit dhe termat e referencës janë ndërtuar mbi nevojën objektive dhe të dokumentuar për ndërhyrje të strukturuar, të vazhdueshme dhe profesionale në menaxhimin e popullatës së kafshëve endacake në territorin e Bashkisë Himarë, ku faktorët urbanë, sezonaliteti turistik dhe densiteti i lartë i lëvizjes së njerëzve krijojnë një ekspozim të shtuar ndaj rreziqeve që lidhen me shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien e kafshëve. Përcaktimi i modelit “Kap–Sterilizo–Vaksino–Lësho” si bosht metodologjik i ndërhyrjes bazohet në konsensusin e praktikave bashkëkohore veterinarë dhe në standardet ndërkombëtare të menaxhimit human të popullatave të kafshëve endacake, të cilat e konsiderojnë këtë qasje si më efektive për reduktim afatgjatë të numrit të kafshëve, duke shmangur ndërhyrjet ekstreme dhe duke adresuar shkakun rrënjësor të problematikës që është riprodhimi i pakontrolluar. Në këtë kontekst, objekti i shërbimit nuk kufizohet në një aktivitet të izoluar operacional, por përfaqëson një sistem të integruar ndërhyrjesh veterinarë, logjistike dhe menaxheriale, i cili kërkon kapacitet të plotë teknik, organizativ dhe profesional për t’u zbatuar në mënyrë efektive.

Përfshirja e të gjitha fazave nga monitorimi në terren deri në rikthimin e kafshëve të trajtuara në habitatin e tyre është e domosdoshme për të garantuar vazhdimësinë logjike dhe epidemiologjike të procesit. Monitorimi fillestar dhe i vazhdueshëm është i nevojshëm për shkak të natyrës dinamike të popullatës së kafshëve endacake, e cila ndikohet nga migrimi, braktisja dhe faktorët sezonalë, veçanërisht në një zonë turistike si Himara. Pa një sistem monitorimi të strukturuar, ndërhyrjet do të humbnin efektivitetin e tyre strategjik dhe do të reduktoheshin në veprime sporadike pa ndikim të qëndrueshëm. Për këtë arsye, kërkohet krijimi i një baze të dhënash dhe hartëzimi i territorit, i cili justifikon nevojën për kapacitet analitik dhe operativ të operatorit ekonomik.

Kapja humane e kafshëve është një komponent kritik që lidhet drejtpërdrejt me parimet e mirëqenies së kafshëve dhe me detyrimet ligjore për shmangien e çdo forme trajtimi të dhunshëm. Përcaktimi i metodave humane dhe i pajisjeve të miratuara nuk është thjesht një kërkesë teknike, por një domosdoshmëri etike dhe ligjore që garanton minimizimin e stresit dhe dëmtimeve fizike, duke reduktuar njëkohësisht rrezikun për operatorët dhe komunitetin. Organizimi i kapjes në orare të caktuara dhe në mënyrë të planifikuar lidhet me nevojën për të minimizuar ndikimin në jetën urbane dhe turistike, duke siguruar që ndërhyrjet të jenë të pranueshme shoqërisht dhe të mos krijojnë shqetësim publik.

Transporti i kafshëve në kushte të kontrolluara dhe me mjete të licencuara është një kërkesë thelbësore e biosigurisë veterinarë, pasi çdo devijim nga standardet e transportit mund të krijojë rrezik për përhapjen e sëmundjeve infektive dhe për përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të

kafshëve të kapura. Përdorimi i kafazeve individuale, dezinfektimi i mjeteve dhe minimizimi i kohës së transportit janë masa të domosdoshme që burojnë nga protokollat standarde veterinarë dhe nga praktikat e mira ndërkombëtare, të cilat synojnë ruajtjen e stabilitetit fiziologjik të kafshëve deri në momentin e trajtimit klinik.

Sterilizimi dhe kastrimi përbëjnë ndërhyrjet themelore biologjike të projektit dhe justifikohen nga nevoja për të ndërprerë ciklin riprodhues të popullatës endacake, duke siguruar një reduktim të qëndrueshëm dhe të matshëm në kohë. Realizimi i këtyre procedurave në ambiente të licencuara dhe sterile, nga personel i kualifikuar dhe nën anestezi të kontrolluar, është një kërkesë që rrjedh drejtpërdrejt nga standardet veterinarë për ndërhyrjet kirurgjikale, ku siguria e kafshës dhe kontrolli i komplikacioneve post-operatorë janë elemente të detyrueshme. Vlerësimi paraprak shëndetësor justifikohet nga nevoja për të shmangur rrezikun anestezik dhe për të garantuar që ndërhyrja të kryhet vetëm mbi individë të përshtatshëm klinikisht.

Trajtimi post-operator është i domosdoshëm për të garantuar suksesin e ndërhyrjes kirurgjikale dhe për të shmangur rikthimin e kafshëve në mjedis në gjendje të paqëndrueshme shëndetësore, çka do të përbënte rrezik si për vetë kafshën ashtu edhe për komunitetin. Ky proces kërkon monitorim të vazhdueshëm, administrim të medikamenteve dhe kushte të kontrolluara higjienike, duke u bazuar në protokollat e rikuperimit veterinar që synojnë reduktimin e infeksioneve dhe komplikacioneve pas operacionit.

Vaksinimi dhe trajtimi antiparazitar janë komponentë të domosdoshëm të shëndetit publik veterinar, pasi kafshët endacake përbëjnë një rezervuar potencial për sëmundje zoonotike. Përfshirja e detyrueshme e vaksinës kundër tërbimit dhe e trajtimeve antiparazitare justifikohet nga rreziku i drejtpërdrejtë që këto sëmundje paraqesin për njerëzit dhe për kafshët e tjera, veçanërisht në zona me qarkullim të lartë turistik dhe kontakt të shpeshtë njeri-kafshë.

Matrikullimi dhe regjistrimi individual i çdo kafshe është një kërkesë thelbësore për krijimin e një sistemi të gjurmueshëm dhe të kontrollueshëm të ndërhyrjeve, i cili garanton transparencë, shmang përsëritjen e trajtimeve dhe mundëson analizë statistikore të efektivitetit të projektit. Ky element e shndërron ndërhyrjen nga një proces i thjeshtë operacional në një sistem të menaxhimit të bazuar në të dhëna, duke rritur ndjeshëm efikasitetin institucional.

Monitorimi i vazhdueshëm dhe raportimi periodik janë të domosdoshëm për sigurimin e kontrollit administrativ dhe teknik mbi zbatimin e kontratës, duke lejuar autoritetin kontraktues të vlerësojë progresin, të identifikojë devijimet dhe të ndërhyjë me masa korrigjuese kur është e nevojshme. Në një projekt me natyrë dinamike dhe sezonale si ky, fleksibiliteti operacional dhe kapaciteti për përshtatje me flukset turistike janë faktorë kritikë për suksesin e ndërhyrjes.

Në përfundim, të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës janë të ndërtuara mbi parimet e proporcionalitetit, domosdoshmërisë dhe efektivitetit, duke synuar jo vetëm zgjidhjen e një problematike aktuale, por krijimin e një sistemi të qëndrueshëm afatgjatë për menaxhimin e kafshëve endacake në Bashkinë Himarë, në përputhje të plotë me standardet veterinarë, kërkesat ligjore dhe objektivat e shëndetit publik.

NJËSIA E PROKURIMIT